

Komisioni për Mbrojtjen e Konkurrencës, në bazë të nenit 28 dhe nenit 19 paragrafi (1) pika 2) të Ligjit për Mbrojtjen e Konkurrencës („Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë“ nr. 145/10, 136/11, 41/2014, 53/16, 83/18 dhe „Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut“ nr. 208/24 dhe 16/25), duke vepruar sipas njoftimit për përqendrim të parashtruar nga Dr. Ing. h.c. F. Porsche Aktiengesellschaft, me seli të regjistruar në adresën Porscheplatz 1, D-70435 Shtuttgart, Republika Federale e Gjermanisë, dhe Rheinmetall AG, me seli të regjistruar në adresën Rheinmetallplatz 1, 40476 Dyseldorf, Republika Federale e Gjermanisë, përmes avokates Ljupka Noveska Andonova nga Shkupi, në seancën e mbajtur më 20.05.2026, miratoi këtë

AKTVENDIM

1.Konstatohet se përqendrimi me të cilin Dr. Ing. h.c. F. Porsche Aktiengesellschaft, me seli të regjistruar në adresën Porscheplatz 1, D-70435 Shtuttgart, Republika Federale e Gjermanisë, dhe Rheinmetall AG, me seli të regjistruar në adresën Rheinmetallplatz 1, 40476 Dyseldorf, Republika Federale e Gjermanisë, do të fitojnë kontroll të përbashkët mbi KS Huayu AluTech GmbH, me seli të regjistruar në adresën Hafenstraße 25, 74172 Neckarsulm, Republika Federale e Gjermanisë, nëpërmjet shitblerjes së një pjese të kapitalit, edhe pse bie nën dispozitat e Ligjit për Mbrojtjen e Konkurrencës, nuk do të ketë si pasojë pengimin, kufizimin ose cenimin e ndjeshëm të konkurrencës efektive në treg ose në një pjesë të tij thelbësore, veçanërisht si rezultat i krijimit ose forcimit të pozitës dominuese të pjesëmarrësve, **dhe është në përputhje me dispozitat e Ligjit për Mbrojtjen e Konkurrencës në kuptim të nenit 19 paragrafi (1) pika 2) të Ligjit për Mbrojtjen e Konkurrencës.**

2.Detyrohet parashtruesi i njoftimit për përqendrim të paguajë taksë administrative për njoftimin për përqendrim në shumën prej 6.000,00 denarë dhe për aktvendimin në shumën prej 30.000,00 denarë, sipas numrit tarifor 34 të Ligjit për Taksat Administrative („Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë“ nr. 17/93, 20/96, 7/98, 13/01, 24/03, 19/04, 61/04, 95/05, 7/06, 70/06, 92/07, 88/08, 130/08, 6/10, 145/10, 17/11, 84/12, 192/15, 23/16 dhe „Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut“ nr. 151/21), në llogarinë e Buxhetit të Republikës së Maqedonisë së Veriut nr. 100000000063095, llogaria e pagesës 840...03161, kodi i të ardhurave dhe programi 72231300.

3.Padia për fillimin e kontestit administrativ nuk e pezullon ekzekutimin e këtij aktvendimi.

Arsyetim

Në përputhje me dispozitat e nenit 15 të Ligjit për Mbrojtjen e Konkurrencës (në tekstin e mëtejshëm: Ligji), më 17.04.2026, ndërsa i plotësuar më 24.04.2026, në Komisionin për Mbrojtjen e Konkurrencës (në tekstin e mëtejshëm: Komisioni) u dorëzua njoftim për përqendrim nga Dr. Ing. h.c. F. Porsche Aktiengesellschaft, me seli të regjistruar në adresën Porscheplatz 1, D-70435 Shtuttgart, Republika Federale e Gjermanisë, dhe Rheinmetall AG, me seli të regjistruar në adresën Rheinmetallplatz 1, 40476 Dyseldorf, Republika Federale e Gjermanisë, me të cilin do të fitojnë kontroll të përbashkët mbi KS Huayu AluTech GmbH, me seli të regjistruar në adresën Hafenstraße 25, 74172 Neckarsulm, Republika Federale e Gjermanisë, nëpërmjet shitblerjes së një pjese të kapitalit.

Komisioni filloi shqyrtimin e njoftimit në ditën e pranimit të tij dhe, në bazë të të dhënave të paraqitura në njoftimin për përqendrim, plotësimit të tij dhe dokumentacionit bashkëlidhës, konstatoi si vijon:

Aktivitetet themelore afariste të ndërmarrjeve të përfshira:

Dr. Ing. h.c. F. Porsche Aktiengesellschaft (në tekstin e mëtejshëm: „Porsche“) është prodhues gjerman i automobilave, i specializuar në zhvillimin, prodhimin dhe shitjen e automobilave sportivë me performancë të lartë, si dhe të automjeteve SUV dhe limuzinave. Porsche është shoqëri e varur nën kontrollin indirekt të Volkswagen Aktiengesellschaft, e cila është shoqëria drejtuese e Grupit Volkswagen.

Grupi Volkswagen është aktiv në nivel global në zhvillimin, prodhimin, marketingun dhe shitjen e automjeteve të pasagjerëve, automjeteve të lehta komerciale, kamionëve, autobusëve, autobusëve turistikë, shasive për autobusë dhe motorëve me naftë, motoçikletave, duke përfshirë pjesët rezervë dhe aksesoret. Grupi Volkswagen është gjithashtu aktiv në shpërndarjen e automjeteve.

Grupi Volkswagen përfshin markat e automjeteve motorike Volkswagen, Volkswagen Commercial Vehicles, Porsche, Audi, Škoda, Bentley, Lamborghini, SEAT, Cupra, MAN, Scania dhe Ducati.

Grupi Volkswagen është i pranishëm në Republikën e Maqedonisë së Veriut përmes shoqërive të varura në vijim:

- Shoqëria për Lizing PORSCHE LEASING SHPKNJP Shkup, me seli të regjistruar në bul. „Bosnja i Hercegovina“ nr. 3, Shkup, me veprimtari prioritare 64.910 – lizing financiar;
- Shoqëria Aksionare për Kryerjen e Veprimtarisë së Brokerimit në Sigurime PORSCHE BROKER SHA Shkup, me seli të regjistruar në bul. „Bosnja i Hercegovina“ nr. 3, Shkup, me veprimtari prioritare 66.220 – veprimtari të agjentëve të sigurimit dhe ndërmjetësve në sigurime;
- Shoqëria për Tregti dhe Shërbime SCANIA MAQEDONIA SHPKNJP import-eksport Ilinden, me seli të regjistruar në rr. „34“ nr. 7, Ilinden, me veprimtari prioritare 46.710 – tregti me shumicë e automjeteve motorike;
- Shoqëria për Tregti dhe Shërbime PORSCHE MAQEDONIA SHPKNJP Shkup, me seli të regjistruar në bul. „Bosnja i Hercegovina“ nr. 4, Shkup, me veprimtari prioritare 46.710 – tregti me shumicë e automjeteve motorike.

Rheinmetall AG është një nga furnizuesit e produkteve inovative për industrinë e mbrojtjes dhe sigurisë, të destinuara për forcat e armatosura dhe forcat e sigurisë gjermane dhe ndërkombëtare. Nëpërmjet divizionit të saj „Sistemet Energjetike“, ajo ofron teknologji dhe komponentë për sistemet e mobilitetit dhe të shtytjes, duke përfshirë komponentë për motorë dhe sisteme të transmetimit të fuqisë për industrinë automobilistike dhe sektorin e energjisë.

Rheinmetall AG nuk ka shoqëri të varura të regjistruara në Republikën e Maqedonisë së Veriut, por ka realizuar të ardhura në Republikën e Maqedonisë së Veriut gjatë vitit 2025.

KS Huayu AluTech GmbH është furnizues në industrinë automobilistike, i specializuar në derdhjen me cilësi të lartë të aluminit për komponentë të lehtë për automjete të pasagjerëve dhe

automjete komerciale, si dhe, në masë të kufizuar, për motoçikleta. Portofoli i prodhimit përfshin:

- komponentë për e-mobilitetin: strehë për bateri dhe strehë për motorë elektrikë;
- komponentë për sistemin e transmetimit të fuqisë: blloqe cilindrash dhe strehë për transmise; kokat e cilindrave nuk përbëjnë veprimtarinë kryesore, pasi ato vetëm përpunohen mekanikisht, ndërsa procesi i derdhjes nuk është pjesë e veprimtarisë së shoqërisë së synuar;
- komponentë të karrocërisë: mbajtëse gjatësore dhe mbajtëse të amortizatorëve;
- komponentë të shasisë: nënkorniza.

KS Huayu AluTech GmbH nuk është e pranishme në Republikën e Maqedonisë së Veriut dhe nuk ka realizuar asnjë të ardhur në Republikën e Maqedonisë së Veriut.

Komisioni konstatoi se përqendrimi i paraqitur bie nën dispozitat e Ligjit, pasi i plotëson kushtet e nenit 12 paragrafi (1) dhe nenit 14 paragrafi (1) pika 1) të Ligjit për Mbrojtjen e Konkurrencës.

Komisioni, duke marrë parasysh kriteret e nenit 17 paragrafët (2), (3) dhe (4) të Ligjit për Mbrojtjen e Konkurrencës dhe pikën 6 b) të *Udhëzimeve për përcaktimin e rasteve në të cilat, gjatë vlerësimit të përqendrimeve, Komisioni për Mbrojtjen e Konkurrencës zakonisht do të konstatojë se ato janë në përputhje me Ligjin për Mbrojtjen e Konkurrencës*, vlerësoi se përqendrimi i paraqitur, edhe pse bie nën dispozitat e Ligjit, është në përputhje me të njëjtin, pasi nuk do të ketë si pasojë pengimin, kufizimin ose shtrembërimin e ndjeshëm të konkurrencës efektive në treg ose në një pjesë thelbësore të tij, veçanërisht si rezultat i krijimit ose forcimit të pozitës dominuese të pjesëmarrësve.

Duke pasur parasysh këtë vlerësim të përqendrimit, Komisioni vendosi si në dispozitivin e këtij Aktvendimi, në përputhje me nenin 19 paragrafi (1) pika 2) të Ligjit.

Në përputhje me nenin 53 paragrafi (2) të Ligjit, padia nuk e shtyn ekzekutimin e aktvendimit.

Udhëzim për mjetin juridik:

Kundër këtij aktvendimi mund të parashtrohet padi për ngritjen e kontestit administrativ pranë Gjykatës Administrative, në afat prej 30 ditësh nga dita e pranimi të aktvendimit.

KOMISIONI PËR MBROJTJEN E KONKURENCËS

KRYETARE

Mr. Малинка Силјановска Николиќ